



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

HARTA RRUGORE E ASK-së PËR VITIN 2017

Dhjetor, 2016
Prishtinë

PARATHËNIE

Ky dokument përmban planin operativ të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2017 të ASK-së, si dhe në Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017, i cili është aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe është vendosur në Gazetën Zyrtare.

Në vitin 2017, ASK-ja do të jetë e përqendruar në: zbatimin e Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2017; zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017; avancimin e sistemit të planifikimit dhe të monitorimit përmes Sistemit të SIPK-ut; zbatimin e ligjeve dhe të rregulloreve ekzistuese dhe ato që priten të aprovohen; ngritjen e kapaciteteve në ASK, posaçërisht në statistikatat ekonomike, statistikatat e tregut të punës dhe në mbledhjen e të dhënave.

Në këtë dokument janë paraqitur aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së, që janë të bazuara në planet dhe detyrat e rregullta, të paraqitura në formë të proceseve rrugore të integruara. Përderisa, planet më të detajuara* ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Në pjesën e parë të vitit 2017, sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja do ta përgatisë një Raport Vjetor, përmes të cilit vlerësohet (matet) performanca e departamenteve, respektivisht arritjeve në ASK dhe në Sistemin Statistikor të Kosovës. Dallimet eventuale, ndërmjet asaj që është planifikuar dhe asaj që është realizuar, barten si pjesë e planit për vitin vijues. Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare të Kosovës, Raporti Vjetor dërgohet në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës për miratim.

* Planet e detajuara nënkuptojnë dokumentet, që i kanë departamentet përkatëse, të cilat cilësohen si “fletë punuese”.

PËRMBAJTJE

	Faqe
1. ORGANIZIMI I ASK-së	4
1.1. Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2016	5
2. KËSHILLI STATISTIKOR.....	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2016	6
3.1. Departamenti i Administratës	6
3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim	7
3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve	8
3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare	8
3.5. Departamenti i Statistikave Sociale dhe të Popullsisë	12
3.6. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.....	15
3.7. Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informativë.....	18
4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORË	20
5. SFIDAT	22
6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA.....	23
7. BUXHETI	29
Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së.....	30

1. ORGANIZIMI I ASK-së

Procesi i ngritjes së kapaciteteve profesionale të ASK-së është një proces dinamik, gjithnjë në funksion të rritjes së performancës dhe përmbushjes së misionit të ASK-së, respektivisht plotësimit të nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të sakta, të besueshme, në kohë dhe të krahasueshme ndërkombëtarëshit. Përpjekjet për zbatimin e plotë të legjislacionit për prodhimin e statistikave zyrtare kanë vazhduar dhe do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2017, duke përfshirë edhe rritjen e burimeve njerëzore. Ngritja e kapaciteteve njerëzore ndërlidhet edhe me obligimet e marra sipas nenit 95 të MSA-së.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare (pritet që Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2017 ta aprovoj plotësim-ndryshimet e këtij Ligji), Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017 dhe MSA-së, para ASK-së shtrohen detyra dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e statistikave zyrtare në nivel vendi, në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore.

Prandaj, si rezultat i Ligjit të lartcekur dhe MSA-së, ASK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme në prodhimin e statistikave zyrtare dhe për çështje të tjera, që parashihen me Ligj dhe me aktet nënligjore.

Si rrjedhojë e kësaj, gjatë vitit 2017, ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve për prodhimin e statistikave zyrtare. Për të gjitha publikimet, e dala nga ASK-ja, do të zbatohen të gjitha metodologjitë dhe standardet e statistikave evropiane;
- Ta paraqesë për miratim, përmes cilit do organ që do ta vendos Kuvendi i Kosovës, Raportin Vjetor 2016 mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar do të publikohet;
- Fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kompetente për statistikave zyrtare, me qëllim që të mundësohet krahasimi i statistikave zyrtare të Kosovës me statistikave të prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Do të rritet përfitimi nga bashkëpunimi statistikor me organizatat ndërkombëtare me pjesëmarrjen e stafit të ASK-së në takime,

punëtori dhe seminare, në fusha të ndryshme statistikore, si dhe me ekspertët ndërkombëtarë në ASK;

- Të bëjtë të gjitha përgatitjet e nevojshme për vlerësimin ndërkombëtar të ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës përmes “Peer Review”
- Të vazhdojë me organizimin e takimeve të Këshillit Statistikor, etj.

1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2016

- Rritja e kapaciteteve profesionale në ASK (njerëzore dhe infrastrukurore) dhe fuqizimi i statistikave ekonomike.
- Prodhimi i statistikave sipas standardeve evropiane dhe botërore dhe zgjerimi i volumit të tyre. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare, zbatimi i metodologjisë statistikore evropiane.
- Avancimi i zbatimit të Kornizës së Vlerësimit të Përformancës (Projekti i SIPK-ut).
- Avancimi i vazhdimësisë së prodhimit të statistikave tremujore të BPV-së dhe statistikave tremujore të Tregut të Punës.
- Sigurimi/rritja i/e buxhetit të nevojshëm nga buxheti i Kosovës, me theks të veçantë në kategorinë Paga dhe Mëditje dhe Mallra e Shërbime për zhvillimin e anketave.
- Zbatimi i Ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Statistikave Zyrtare

2. KËSHILLI STATISTIKOR

Këshilli përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë ministritë kyçe, Bankën Qendrore, Administratën Tatimore, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile, siç janë cekuar më poshtë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Ministria e Shëndetësisë,
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,
- Ministria e Financave,
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
- Universiteti i Prishtinës,

- Administrata Tatimore e Kosovës,
- Zyra e Planifikimit Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit,
- Aleanca Kosovare e Bizneseve,
- Instituti për Menaxhimin e Ndërmarrjeve dhe Inxhinieri (IMNI).

Këshilli Statistikor, ashtu siç ka vepruar deri më tash, do të jep rekomandime mbi përgatitjen dhe realizimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017, si dhe mbi zhvillimin dhe funksionimin e gjithmbarshme të ASK-së, respektivisht Sistemit Statistikor të Kosovës.

Këshilli është themeluar me Vendim të Kryeministrit dhe do të funksionojë në mbështetje të Rregullores së miratuar, komfor Ligjit për Statistika Zyrtare, me përbërjen aktuale me afat deri në muajin Mars të vitit 2017. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të Statistikave Zyrtare, të ndryshuar dhe plotësuar, do të plotësohet edhe Këshilli Statistikor me anëtarë të rinj. Këshilli Statistikor ka dërguar Raportin e parë (I) në ZKM, ndërkohë është në proces Raporti hartimit të Raportit të radhës për të gjithë periudhë pesvjeçare.

3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2016

Një ndër qëllimet e ASK-së është ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale sipas standardeve dhe metodologjive të kërkuara nga Eurostat. Ky zhvillim i departamenteve do të bëhet në pajtim me politikat e diseminimit për: evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme në publikimet e ASK-së; zhvillimin e mëtejshëm të metodologjive dhe teknologjisë statistikore; zhvillimin e politikave të standardizimit dhe mbështetjen me ekspertë ndërkombëtarë për zbatimin e këtyre standardeve.

ASK-ja, në kuadër të këtij zhvillimi, do të ofrojë ndihmë profesionale për interpretimin e saktë të të dhënave zyrtare statistikore.

Më poshtë janë dhënë zhvillimet e parapara sipas departamenteve për vitin 2017.

3.1. Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative ditore në ASK, si: operacione financiare, kontabilitet, prokurim, rekrutime, gjegjësisht procedura, administrim i personelit (vijueshmëria në punë, largime, dosje personale, etj.), furnizime, logjistikë, etj. Shprehur me fjalë të tjera, përgatitja e pasqyrave financiare, raporteve mujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore; shërbime të personelit, duke mbuluar mirëqenien,

rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; prokurimin dhe shërbimet për menaxhimin e kontratave (menaxhimi i aseteve, pronës dhe shërbimet e logjistikës). Në kuadër të Departamentit të Administratës janë të angazhuar një drejtor dhe 12 zyrtarë për vitin 2017, ku i njëjti numër i stafit do të jetë edhe gjatë vitit 2017.

Një prej pikave kyçe do të jetë zbatimi i Planit të Punës 2017, si dhe respektimi i të gjitha procedurave, gjegjësisht legjislacionit në fuqi, në funksion të menaxhimit të aktiviteteve të lartcekura.

3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim

Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim (DPPKK) është themeluar në bazë të Rregullores për Riorganizimin e ASK-së dhe si i tillë është departament i ri në ASK. Gjatë periudhës një vjeçare të vitit 2016, ky departament është konsoliduar dhe stabilizuar. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit janë të përshkruara në Rregulloren për Riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Në bazë të kësaj DPPKK është përgjegjës për planifikimin në ASK, për përmirësimin e bashkëpunimit (me institucionet vendore dhe ndërkombëtare), koordinimin (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), zhvillimin dhe zbatimin e politikave në fushën e statistikave, si dhe monitorimin e prodhimit të statistikave zyrtare. Po ashtu, ky departament ka rol qendror në monitorimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017.

Gjatë vitit 2017 DPPKK-ja do të ofrojë këshilla në kontekstin e zhvillimeve dhe kërkesave ndërkombëtare në fushën e statistikave për ASK-në dhe Sistemin më të gjerë Statistikor të Kosovës dhe për palët e tjera të interesuara sipas nevojës. Sigurimi i informacioneve (të dhënave analitike) të Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së lidhur me performancën e departamenteve prodhuese dhe mbështetëse në ASK është një nga qëllimet për planet e departamentit në fjalë. Në këtë kontekst, do të hartohen raporte analitike për departamentet prodhuese përmes të dhënave nga sistemi i SIPK-ut, dhe burimet e tjera mbi bazën e të cilave do të krijohet një pasqyrë e përgjithshme për menaxhmentin e lartë në ASK, për vendimmarrje, bazuar në evidencë (shënime). Disa nga pikat (projektet/aktivitetet) më të rëndësishme të cilat priten të realizohen nga DPPKK për vitin 2017 janë si në vijim: hartimi i Planit Vjetor të Punës 2018, hartimi i Programit të dytë afatgjatë i statistikave zyrtare 2018-2022, organizimi dhe mbështetja e procesit “Peer Review” e lansuar nga Eurostat. Po ashtu të gjitha kërkesat (sigurimi i të dhënave) qoftë ne aspektin e brendshëm dhe të jashtëm si rezultat i proceseve të integritimit evropian.

Krijimi i një sistemi dialogues me shfrytëzuesit e të dhënave zyrtare në mënyrë që të adresohen kërkesat e shfrytëzuesve nga pikëpamja e cilësisë dhe vëllimit të të dhënave statistikore do të jetë pjesë e planit të DPPKK-së gjatë vitit 2017 dhe në të ardhmen.

3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve (DRA) është përgjegjës për zbatimin dhe organizimin e regjistrimeve dhe anketave sociale, ekonomike, bujqësore, si dhe mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave të tjera që kërkohen nga ASK-ja, si dhe do të angazhohet në ngritjen e cilësisë së të dhënave statistikore në përgjithësi.

DRA ka nën menaxhimin e vet shtatë (7) Zyrat Rajonale të ASK-së. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve do ta ketë rolin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve operative të Zyrave Rajonale të ASK-së lidhur me mbledhjen e të dhënave në terren.

Ky departament në aspektin e organizimit ka pësuar disa ndryshime të vogla, ku të gjithë udhëheqësit e Zyrave Rajonale raportojnë drejtpërdrejt te Drejtori i DRA-së.

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve për vitin 2017 planifikon të bëjë harmonizimin e metodave për grumbullimin e të dhënave për anketa, si dhe do ta bëjë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëve në kuadër të anketave të nevojshme për departamentet prodhuese. Po ashtu, do të ofrojë bashkëpunim me departamentet e tjera në ASK dhe jashtë ASK-së. Ndërkohë, departamenti do t'i përgatisë raportet mbi ecurinë e aktiviteteve të parapara.

Për vitin 2017 ky departament do mbështes aktivitetet e studimit të fizibilitetit për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave për vitin 2020 sipas rekomandimeve dhe praktikave ndërkombëtare - Eurostatit për vitin 2020.

3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare

Sipas strukturës organizative aktuale të ASK-së, departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare përbëhet nga tri divizione: Divizioni i Llogarive Kombëtare, Divizioni i Statistikave të Çmimeve dhe Divizioni i Ndërmarrjeve dhe Statistikave të Tregtisë së Jashtme.

Në programin e vitit 2017, në bazë të resurseve në dispozicion, departamenti ka këto prioritete: shkurtimin e afatit të publikimit të të gjitha publikimeve (mujore, tremujore dhe vjetore); fillimin e publikimeve të reja tremujore, si Llogaritë Qeveritare; përmirësimin e metodologjisë së përpilimit të Llogarive Kombëtare në baza vjetore, sipas ESA 2010 dhe SNA 2008; përmirësimin e cilësisë së Regjistrit të Bizneseve; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të turizmit; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të transportit; përmirësimin e statistikave të çmimeve;

Përfundimi i detyrave të pilot-projektet e IPA 2014 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse;

Vazhdimi i asistencës teknike nga SIDA, për Statistikat e Çmimeve; asistencës teknike të FMN-së për Statistikat e Financave Qeveritare, do të jenë mundësi e mirë për arritjen e objektivave.

Më poshtë është lista e publikimeve të planifikuara në Departamentin e Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare në vitin 2017.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së jashtme	Dhj 2016	Jan 2017	Shk 2017	Mar 2017	Prill 2017	Maj 2017 & 2016 vj	Qer 2017	Kor 2017	Gush 2017	Sht 2017	Tet 2017	Nën 2017
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Dhj 2016	Jan 2017	Shk 2017	Mar 2017	Prill 2017	Maj 2017 & 2016 vj	Qer 2017	Kor 2017	Gush 2017	Sht 2017	Tet 2017	Nën 2017
Statistikat e Hotelerisë			TM4 /2016			TM1 /2017			TM2 /2017			TM3 /2017
Indeksi i çmimit të importit			TM4 /2016			TM1 /2017			TM2 /2017			TM3 /2017
Bilanci i Energjisë në Kosovë		TM4 /2016			TM1 /2017		2016 vj	TM2 /2017			TM3 /2017	
Indeksi i çmimeve të prodhimit			TM4 /2016			TM1 /2017			TM2 /2017			TM3 /2017
Rep.stat mbi ndërmarrjet në Kosovë	TM4 /2016				TM1 /2017		TM2 /2017			TM3 /2017		
Statistikat e Transportit	TM4 /2016				TM1 /2017		TM2 /2017			TM3 /2017		
Llogarit Qeveritare				TM4 /2016		2016	TM1 /2017			TM2 /2017		TM3 /2017
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Shpenzimeve & Prodhimit										2016		
Rezultatet e Anketes Strukturore te ndërmarrjeve												2016
BVP tremjore-Qasja e shpenz. dhe prodhimit				TM4 /2016		TM1 /2017			TM2 /2017			TM3 /2017
Indeksi i Kostos se Ndërtimit			TM4 /2016			TM1 /2017			TM2 /2017			TM3 /2017
Statistikat tremjore per Industri			TM4 /2016			TM1 /2017			TM2 /2017			TM3 /2017
Statistikat tremjore per Tregti me pakice			TM4 /2016			TM1 /2017			TM2 /2017			TM3 /2017
Rezultatet e Anketës se PRODCOM-it*												2016

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Gjatë vitit 2017 planifikohen të realizohen këto aktivitete, sa i përket statistikave makroekonomike.

a) Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2016:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-qershor 2017;

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj -shtator 2017;
 - Përgatitja e të dhënave përfundimtare për BPV, tetor 2017;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2017.
- b) Anketa për Azhurnimin e Regjistrit Statistikor të Bizneseve 2016:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), shkurt-tetor 2017;
 - Kontrolli Logjik, kodimi, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill -dhjetor 2017.
- c) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM4 2016:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar -shkurt 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2017;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2017.
- d) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM1 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-qershor 2017;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2016.
- e) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM2 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik -shtator 2017;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2017.
- f) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM3 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor-dhjetor 2017;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2017.
- g) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM4 2016:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar - shkurt 2017;
- h) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM1 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2017;
- i) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM2 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2017;
- j) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM3 2017:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2017;
- k) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM4 2016:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar-mars 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, shkurt-mars 2017;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2017.
- l) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM1 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill -maj 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj-qershor 2017;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2017.
- m) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM2 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, gusht-shtator 2017;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2017.
- n) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM3 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, nëntor-dhjetor 2017;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2017.
- o) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM4 2016:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar -shkurt 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2017;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2017.
- p) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM1 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-qershor 2017;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2017.
- q) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM2 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik-shtator 2017;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2017.
- r) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM3 2017:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor-dhjetor 2017;

- Publikimi i të dhënave, dhjetor 2017.
- s) Anketa e PRODCOM-it 2016:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar-mars 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-dhjetor 2017;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2017.
- t) Anketa Konsumi i Energjisë Elektrike në sektorët ekomomike (shërbimet dhe transporti)
- Anketimi i në teren, prill-qershor 2017;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, qershor - korrik 2017;
 - Publikimi i të dhënave, bëhet në kuadër të balancës së energjisë, shtator 2017.
- u) Pilot-Projektet e IPA 2012 (MB)* - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumë përfitues IPA 2014:
- Pariteti i Fuqisë Blerëse;
 - Metodologjia e Llogarive Kombëtare;
 - Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve;
 - Statistikat e Tregtisë së Jashtme për Mallra;
 - Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit;
 - Statistikat e Transportit;
 - Statistikat e Turizmit;
 - Programi i dërgimit të të dhënave ESA 2010;
 - Llogaritë Qeveritare
 - Përmirësimi i Regjistrit Kombëtar të Statistikave të Biznesit;
 - Identifikimi i burimit të të dhënave për kalkulimin e treguesve për sistemet e pa barazimeve makroekonomike.

/* Dinamika e realizimit të pilot-projekteve të IPA 2014 do të jetë sipas kontratës së nënshkruar. Të gjitha pilot projektet pritet do të përfundojnë në fillim të pjesës së dytë të vitit 2017.

3.5. Departamenti i Statistikave Sociale dhe të Popullsisë

Departamenti i Statistikave Sociale (DSS), përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Statistikave Sociale dhe Divizioni i Statistikave të Popullsisë. DSS është përgjegjës për prodhimin e statistikave sociale dhe statistikave të popullsisë.

Departamenti i Statistikave Sociale do të vazhdojë me nxjerrjen e publikimeve të rregullta sipas Kalendarit të Publikimeve 2017.

Prioritetet e DSS-së për vitin 2017 janë: Përgatitja e planit strategjik për regjistrimin e popullsisë (roundi 2020). Vazhdimi i publikimit të rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore në baza tremujore, si dhe publikimi vjetor; zhvillimi i Anketës për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës si hulumtim i rregullt; zhvillimi i Anketës për Përdorimin e Teknologjisë Informative të Komunikimit në ekonomitë familjare, harmonizimi me standardet dhe metodologjitë e Eurostatit, duke shtuar indikatorë të rinj; rritja e cilësisë së të dhënave, duke rritur shkallën e monitorimit në terren për Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) dhe Anketën e Fuqisë Punëtore; grumbullimi i të dhënave të Statistikave të Arsimit përmes Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (ASK-MASHT); dhe digjitalizimi i të dhënave të Statistikave Vitale (ASK-MPB); Pjesëmarrja në Pilot-Projektet e IPA 2014; Vazhdimi i asistencës teknike nga SIDA për statistikën e ABEF-it dhe Statistikat e Arsimit dhe Statistikat Gjinore; Vazhdimi i asistencës teknike nga Banka Botërore për Statistikat e Varfërisë, etj.

Lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Sociale në vitin 2017

Muaji i botimit	Janar	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare						2016						
Anketa e Fuqisë Punëtore	TM3 2016			TM4 2016	Përmbledhj e vjetore 2016		TM1 2017			TM2 2017		TM3 2017
Statistikat e Jurisprudencës për personat të mitur						2016						
Statistikat e Jurisprudencës për personat të madhor									2016			
Statistikat e Arsimit						2016 / 2017						
Statistikat e Kulturës										2016		
Statistikat e Mirëqenies Sociale				2016								
Statistikat e Shëndetësisë											2016	
Statistikat e Sportit												2016
Statistikat e Lindjeve						2016						
Statistikat e Vdekjeve						2016						
Statistikat e Kurorezimeve							2016					
Statistikat e Shkurorëzimeve							2016					
Statistikat për shkaqet e vdekjeve												2014/ 2015
Vlerësimi i popullsisë						2016						

Publikimet e pritura nga Departamenti i Statistikave Sociale, që do te realizohen në vitin 2017 janë:

- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM3 2016;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM4 2016;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) përmbledhje vjetore 2016;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM1 2017;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM2 2017
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM3 2017
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Buxhetit dhe Ekonomive Familjare (ABEF) 2016;
- Publikimi i Statistikave të Arsimit 2016/2017;
- Publikimi i Statistikave të Mirëqenies Sociale 2016;
- Publikimi i Statistikave të Jurisprudencës për Personat e Mitur 2016;
- Publikimi i Statistikave të Jurisprudencës për Personat Madhorë 2016;
- Publikimi i Statistikave të Shëndetësisë 2016;
- Publikimi i Statistikave të Kulturës 2015;
- Publikimi i Statistikave të Sportit 2015;
- Vlerësimi i Popullsisë 2016;
- Statistikat e Lindjeve 2016;
- Statistikat e Vdekjeve 2016;;
- Statistikat e Kurorëzimeve 2016;
- Statistikat e Shkurorëzimeve 2016;
- Statistikat për Shkaqet e Vdekjeve 2014/2015.

Aktivitetet e tjera

- Zhvillimi i Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (AAKJ) SILC;
- Zhvillimi i Anketës për Përdorimin e Teknologjisë Informative të komunikimit në ekonomitë familjare (ICT);
- Realizimi i pilot projektit të IPA 2014 për statistikat e jurisprudencës-zhvillimi i statistikave zyrtare për veprat penale dhe drejtësinë penale

- Realizimi i pilot projektit të IPA 2014 për Anketën e Fuqisë Punëtore – rritja e cilësisë së të dhënave të AFP 2017;
- Digjitalizimi i të dhënave të Statistikave Vitale – vazhdon bashkëpunimi me Agjencinë e Regjistrimit Civil, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). ASK do ta udhëheq Projektin e digjitalizimit të Statistikave Vitale, qasjen në bazën e Regjistrimit Civil me inkuorporimin e disa pyetjeve të nevojshme në platformë si dhe me bazën për Lindje dhe Vdekje nga Sistemi Informativ i Shëndetësisë Rishikimi i bazave (mundësia e qasjes) të tjera të të dhënave të rëndësishme për marrjen e të dhënave administrative;
- Krijimi i modulit për çasje në bazë të të dhënave të Programit SMIA, në kuadër të MASHT-it.

3.6. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit (DSBM) do të jetë përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e statistikave zyrtare, të besueshme dhe me kohë për bujqësi, pylltari, statistika agro-monetare dhe të mjedisit, si dhe standardizimin e prodhimit të këtyre statistikave me BE-në.

Bazuar në strukturën e re të organizimit të ASK-së, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit ka dy divizione në kuadër të saj: Divizioni i Statistikave të Bujqësisë dhe Divizioni i Statistikave të Mjedisit. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit do të vazhdojë nxjerrjen e botimeve të rregullta, të parapara në Kalendarin e Publikimeve 2017. Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në vitin 2017.

Muaji i botimit	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi	(2010-2016 vjetore) & TM4/ 2016			TM1/ 2017			TM2/ 2017			TM3/ 2017	
Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi	2010-2016 vjetore) & TM4/ 2016			TM1/ 2017			TM2/ 2017			TM3/ 2017	
Anketa e Mbeturinave Industriale											2016
Anketa e Mbeturinave Komunale										2016	
Anketa e Mbeturinave të Trajtuar									2016		
Anketa e Ekonomive Bujqësore 2016								2017			
Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi 2016										2016	
Disa Fakte mbi Mjedisin, 2017					2017						

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin, në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Gjatë vitit 2017 planifikohen të realizohen këto aktivitete, sa i përket statistikave të bujqësisë dhe mjedisit.

1. Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2016

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave të Anketës së Ekonomive Bujqësore 2016 (AEB 2016), janar -Korrik 2017;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AEB 2016, Gusht -Shator 2017;
- Publikimi i të dhënave, Shator 2017.

2. Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2017

- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Ekonomive Bujqësore 2017 (përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit dhe e mostrës, Tetor 2017.
- Anketimi i Ekonomive Bujqësore të zgjedhura (mostra), Nëntor – Dhjetor 2017;

3. Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi 2016

- Grumbullimi i të dhënave administrative për Llogaritjet ekonomike në bujqësi 2016 Janar-Qershor 2017.
- Përpunimi, analiza dhe përgatitja e të dhënave përfundimtare, Korrik-Tetor 2017.

- Publikimi i të dhënave, Nëntor 2017.

4. Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi

- Grumbullimi i të dhënave për çmimet e prodhimeve dhe inputeve bujqësore çdo muaj, Janar-Dhjetor 2017.
- Përfshirja në kompjuter, përpunimi, analiza dhe përgatitja e publikimeve tremujore dhe vjetore.
- Publikimi i të dhënave vjetore, shkurt 2017.
- Publikimi i të dhënave tremujore, shkurt, maj, gusht dhe nëntor, 2017,

5. Fakte mbi Mjedisin 2016;

- Grumbullimi i të dhënave administrative dhe të tjera për publikimin “Fakte mbi mjedisin”, janar – Prill 2017.
- Përpunimi, analiza dhe përgatitja e rezultateve përfundimtare, Prill-Qershor 2017.
- Publikimi i të dhënave, Qershor 2017.
- Anketa e Mbeturisë të Trajtuara (AMT) 2016
- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Mbeturisë të Trajtuara (AMT) 2016 (përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit dhe e mostrës, janar -qershor 2017.
- Anketimi i Ndërmarrjeve Industriale të zgjedhura (mostra), Korrik-Gusht 2017.
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, shtator 2017;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AMT dhe publikimi i tyre, shtator 2017;

6. Anketa e Mbeturisë Industriale 2016 (AMI)

- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Mbeturisë të Trajtuara (AMT) dhe Anketës së mbeturisë Industriale (AMI) 2017 (përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit dhe e mostrës, janar -qershor 2017.
- Përpunimi dhe Analiza e të dhënave të AMI, Tetor 2017
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AMI, Nëntor 2017.
- Publikimi i të dhënave të AMI, Dhjetor 2017.

7. Anketa e Mbeturisë Komunale

- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Mbeturisë Komunale (AMK) 2017 (përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit dhe e mostrës, janar -qershor 2017.

- Anketimi i Ndërmarrjeve që merren me grumbullimin e mbeturinave komunale, Korrik – Gusht 2017.
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave të AMK, shtator 2017;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AMK dhe publikimi i tyre, Tetor 2017.

Aktivitet e tjera

1. Realizimi i pilot-projekteve në kuadër të IPA 2014:
 - a. Statistikat Vjetore të Kulturave Bujqësore;
 - b. Statistikat e Prodhimtarisë Blegtorale (statistikat mujore dhe vjetore mbi therjet e kafshëve, statistikat mujore dhe vjetore mbi prodhimin e qumështit).

Regjistrimi i Bujqësisë

- Prodhim i të dhënave sipas kërkesave të shfrytëzuesve nga të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë 2014.

3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative

Divizioni i Teknologjisë Informative (TI-së) do të vazhdojë t'i mbështesë departamentet prodhuese, në krijimin e programeve dhe ueb aplikacioneve të ndryshme për grumbullimin e të dhënave ne terren, azhurnimi i qarqeve regjistruese dhe fuqizimi i GIS për menaxhimin e të dhënave gjeo-hapësinore, menaxhimin dhe unifikimin e mëtejme të bazës së shënimeve, modernizimi i vazhdueshëm i shpërndarjes së të dhënave, krijimi i sistemit të metadatave etj.

Në mbështetje të BB-së do të zhvillohet platforma CAPI përmes survey solution, një platformë e zhvilluar nga BB për grumbullimin e të dhënave për anketën e SILC.

Do të zhvillohen disa aplikacione për grumbullimin e të dhënave përmes uebit për disa pilot projekte të mbështetura nga Eurostat.

Modernizimi i shpërndarjes së të dhënave përmes platformes ASKDATA do të vazhdojë, pasi objektivi i ASK-së është që deri më 2017 ASKDATA të jetë kanali kryesor i shpërndarjes së të dhënave.

Zhvillimi i mëtejme i ueb faqes së re në platformën ASP.NET do të vazhdojë, ku parashifet lidhja me ueb aplikacione, shpërndarja e metadatave sipas standartit të Eurostat ESMS si dhe zhvillimi i veglave për vizualizim (grafikone dhe harta interaktive).

Do të intensifikohet bashkëpunimi me institucionet qeveritare, me qëllim të unifikimit të sistemeve dhe shkëmbimit e të dhënave administrative.

Zbatimi dhe integrimi i SharePoint në ASK, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i Sistemit të Përfshirjes së Kohës (SIPK) do të vazhdojë edhe në vitin 2017.

Do të mbështes departamentet prodhuese në transmetimin e të dhënave në Eurostat përmes platformës eDAMIS.

Ndërsa si aktivitete shtesë për Divizionin e Metodologjisë dhe Shpërndarjes për vitin 2017 planifikohen këto aktivitete.

- Sektori i Shpërndarjes do të vazhdojnë të punojë dhe t'i mbështesë departamentet prodhuese, lidhur me kontrollimin dhe përgatitjen e të gjitha publikimeve statistikore, duke zbatuar standardet e Eurostatit, si dhe duke përfshirë këtu edhe shenjzimin e numrit standard të ISBN-së për të gjitha publikimet vjetore të statistikave.
- Kalendari i Publikimeve 2017 do të jetë instrument shumë i rëndësishëm, që sektori i shpërndarjes-desiminimit përgatit dhe bën kontrollimin dhe verifikimin e afateve kohore të publikimeve, në bazë të deklaramit të datave për publikimin e tyre nga përgjegjësit e departamenteve prodhuese të ASK-së.
- Informimi i shfrytëzuesve për arsyen dhe vonesën e publikimeve është një informatë shtesë ku me këtë lloj informate shfrytëzuesit e të dhënave janë të informuar me kohë lidhur me datën se kur do të publikohen të dhënat të cilat nuk janë publikuar në kohë.
- Përkthimi i të gjitha publikimeve dhe dokumenteve zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe angleze do të jetë punë e këtij sektori edhe gjatë vitit 2017.
- Shpërndarja e publikimeve statistikore, në mënyrë elektronike në adresat e shfrytëzuesve.
- Vazhdimi i publikimeve horizontale tremujore dhe vjetore, të cilat janë si rezultat i statistikave prodhuese do të jenë proces në vazhdimësi për prezantimin e të dhënave kyçe për shfrytëzuesit dhe përdoruesit.
- Vjetari Statistikor i ASK-së, i cili planifikohet të përgatitet gjatë muajve të parë të Vitit 2017.
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Buxhetit Familjar;
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Fuqisë Punëtore si dhe Anketën e Ekonomive familjare Bujqësore;
- Nxjerrja e Mostrës për anketën “SILC (Survey on Income and Living Conditions)”
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën “ICT (Information & Communication Technology Survey)”

- Nxjerrja e Mostrave edhe për Hulumtime tjera shitesë të cilat mund të kërkohen nga Institucionet e ndryshme ndërkombëtare apo edhe ato vendore;
- Llogaritja e Peshave për Hulumtimet dhe Anketat e lartcekura;
- Rivlerësimi i peshave për hulumtimet e ndryshme statistikore;
- Llogaritja e gabimeve të Mostrës për dy produkte të tjera statistikore;
- Vazhdimi i projektit për Metadata;
- Përpilimi i planit për mbështetje në sektorin e Metodologjisë për vitin 2018 nga SIDA Suedeze.

Ndërsa nga fusha e Shpërndarjes, për vitin 2017 planifikohen të bëhen këtë publikime të ashtuquajtura horizontale:

Muaji i botimit	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Vjetari Statistikor						2016						
Kosova në Shifra									2016			
Buletini tremujor	TM4 2016			TM1 2017			TM2 2017			TM3 2017		
Fletëpalosja e ASK-së												2017
Kalendari i botimeve të ASK-së											2017	
Kalendari vjetor i ASK-së												2017
Katalogu i publikimeve të ASK-së			2016									

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahen

4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORË

- Ndihma e donatorëve ka dhënë vazhdimisht ndikim në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe në përmirësimin e produkteve statistikore të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për institucionet dhe përdoruesit e statistikave në tërësi.
- Në kuadër të mbështetjes nga donatorët, ASK-ja ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Zyrën e BE-së në Kosovë, SIDA/SCB, FMN, UNFPA, UNICEF, UNDP, etj.
- Ngritja e kapaciteteve dhe ndihma në fushën e projekteve do të jetë e vazhdueshme dhe me shumë interes për ASK-në. Gjatë vitit 2017, donatorët do ta mbështesin stafin në ngritjen e kapaciteteve në shumë aktivitete të ndryshme, me numër të konsiderueshëm

pjesëmarrjeje në të gjithë sektorët e statistikave. Vazhdimi i mbështetjes së stafit të ASK-së për pjesëmarrje në takime, konferenca, trajnime, takime pune, grupe të punës, që janë të planifikuara në instrumentin planifikues të aktiviteteve, MC-listë dhe nga Katalogu i takimeve ESTP mbështetur nga Eurostat-i dhe organizatat e tjera për vitin 2017.

- Koordinimi i aktiviteteve në baza mujore, për takimet e stafit të ASK-së, realizimi i takimeve, aprovimet dhe raportet e aktivitetit, etj.

Komisioni Evropian përmes Programit IPA 2014 (i planifikuar për periudhën dy vjeçare), gjatë vitit 2016-2017 ka mbështet dhe do të vazhdojë ta mbështesë ASK-në me 21 pilot-projekte, nga 10 që ishin në kuadër të programit IPA 2012.

Pilot-projektet IPA 2014 për 2016 dhe 2017

1	National accounts methodology
2	ESA 2010 transmission programme
3	Government Finance Statistics
4	Price Statistics - PPPs
5	Quality management
6	Improvement of the national statistical business register
7	Development of official statistics on crime and criminal justice
9	EU-SILC implementation
10	Trade in goods statistics
12	Information Society Statistics (ISS)
13	Transport statistics
14	Short-term business statistics
15	Tourism statistics
16	Labour force survey
17	Price Statistics - HICP
18	Developing a metadata system
19	South East Europe 2020 (SEE2020) indicators
20	Source (basic) data required for the calculation of the indicators for the Macro-economic imbalances procedure (MIP)
21	Crops statistics
22	Animal Production Statistics
23	Reporting on horizontal activities

- ASK-ja ndihmon me aktivitetet rreth realizimit të pivate projekteve duke koordinuar aktivitete si: ToR, kontratave, faturave, raportet e të gjitha aspekteve tjera koordinuese që dalin gjatë procedimit në realizimin e plotë për secilin pilot projekt.

- Koordinimi i aktiviteteve me departamentet në kuadër të dërgimit të të dhënave vjetore te Eurostati për treguesit e shumtë statistikorë. Dy raunde brenda vitit “Mbledhja e të dhënave”.
- Koordinimi i aktiviteteve me departamentet në kuadër të mbledhjes dhe plotësimit të të dhënave për SMIS+.
- Organizimi i mbarëvajtjes së takimeve të Komitetit Drejtues të Projektit të SIDA-së (në baza tremujore). Mbajtja e minutave të takimit për projektin e SIDA-s në vazhdimësi.
- Vazhdimi dhe rritja e bashkëpunimit të vazhdueshëm me donatorët dhe koordinimi i projekteve të mbështetura nga donatorët.
- Bashkëpunimi me departamentet dhe realizimi në kohë i proceseve statistikore.
- Koordinimi i proceseve statistikore me vendet e BE-së dhe të rajonit, harmonizimi i tyre në kuadër të Strategjisë 2014-2020.
- ASK-ja ka një mbështetje të lartë nga donatorë të ndryshëm në përmirësimin e proceseve të produkteve statistikore. Tabela me poshtë tregon emrin e projekteve në zbatim, si dhe emrin e mbështetjes nga donatorët:

Projektet e mbështetura nga Donatorët, që janë në proces të zhvillimit dhe ato që vazhdojnë në vitin 2017	Donatorët:
Zhvillimi i Statistikave në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) 2013-2017	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida/SCB)
Mbështetja dhe ngritja e kapaciteteve afatgjata për ASK-në	UNICEF
IPA 2014 – Programi shumëpërfitues i Bashkëpunimit Statistikor	Eurostati

5. SFIDAT

Një ndër sfidat kryesore të ASK-së në vitin 2017 do të jetë mungesa e buxhetit dhe mungesa e stafit.

Po ashtu, sfidat e tjera me të cilat pritet të ballafaqohet ASK-ja janë:

- zbatimi i Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017 (PSZ);
- zbatimi i Planit Kombëtar për MSA-në, në fushën e statistikave;

- sigurimi i indikatorëve, gjegjësisht monitorimi i strategjisë SEE 2020;
- përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave statistikore;
- përgatitja sa më e mirë e ASK-së për vlerësimin “Peer Review”
- krijimi i një sistemi unik statistikor të TI-së;
- zbatimin e Kornizës së Vlerësimit të Përformancës së PVSZ (për disa indikatorë);
- kuadri i burimit të të dhënave, ende i pamjaftueshëm
- harmonizimi i statistikave ndërmjet ASK-së dhe ministrive, që janë prodhuese të statistikave;
- implementimi i pilot-projekteve IPA 2014
- Aprovimi nga ana e Zyrës së BE-së për aplikimin e ASK-së për projektin në kuadër të IPA 2017.

6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & QASJA

- Azhurnimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i platformës për shpërndarjen e bazës së shënimeve ASKDATA do të vazhdojë, pasi objektivi i ASK-së është që deri më 2017, ASKDATA të jetë kanali kryesor i shpërndarjes së të dhënave.
- Ofrimi i të dhënave statistikore në ueb-faqen e ASK-së në formatin PDF , Excel për të gjitha departamentet statistikore.

Kalendari i Publikimeve 2017

12.01.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Dhjetor 2016
13.01.2017	Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	TM3 2016
25.01.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Dhjetor 2016
31.01.2017	Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë	TM4 2016
31.01.2017	Statistikat e Transportit	TM4 2016
31.01.2017	Buletini Tremujor	TM4 2016
09.02.2017	Indeksit Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi	TM4 2016

14.02.2017	Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimeve në Bujqësi	TM4 2016
15.02.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Janar 2017
16.02.2017	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM4 2016
24.02.2017	Indeksit Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi	2010-2016
28.02.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Janar 2017
28.02.2017	Indeksit Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi	2010-2016
09.03.2017	Statistikat e Hotelerisë	TM4 2016
09.03.2017	Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP)	TM4 2016
10.03.2017	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP)	TM4 2016
13.03.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Shkurt 2017
13.03.2017	Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN)	TM4 2016
20.03.2017	Katalogu i Publikimeve	2016
21.03.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Industrisë	TM4 2016
23.03.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me Pakicë	TM4 2016
24.03.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Shkurt 2017
03.04.2017	Statistikat e Mirëqenies Sociale	2016
06.04.2017	Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit	TM4 2016
11.04.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Mars 2017
14.04.2017	Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	TM4 2016
20.04.2017	Llogaritë Qeveritare	TM4 2016
25.04.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Mars 2017

28.04.2017	Buletini Tremujor	TM1 2017
02.05.2017	Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë	TM1 2017
02.05.2017	Statistikat e Transportit	TM1 2017
11.05.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Prill 2017
12.05.2017	Indeksit Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi	TM1 2017
15.05.2017	Indeksit Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi	TM1 2017
15.05.2017	Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	2016
19.05.2017	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM1 2017
25.05.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Prill 2017
06.06.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	2016
07.06.2017	Statistikat e Hotelerisë	TM1 2017
07.06.2017	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM1 2017
08.06.2017	Llogaritë Qeveritare	2016
08.06.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	2016
09.06.2017	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP)	TM1 2017
12.06.2017	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF)	2016
12.06.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Maj 2017
12.06.2017	Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN)	TM1 2017
14.06.2017	Statistikat e Lindjeve	2016
15.06.2017	Statistikat e Arsimit	2016\2017
20.06.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Industrisë	TM1 2017
22.06.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me Pakicë	TM1 2017

23.06.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	Maj 2017
26.06.2017	Disa Fakte mbi Mjedisin	2016
27.06.2017	Statistikat e Jurisprudencës për Persona të Mitur	2016
29.06.2017	BPV me Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve	TM1 2017
29.06.2017	Vlerësimi i Popullsisë	2016
30.06.2017	Statistikat e Vdekjeve	2016
30.06.2017	Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës	2017
05.07.2017	Bilanci i Energjisë në Kosovë	2016
10.07.2017	Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	TM1 2017
11.07.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Qershor 2017
14.07.2017	Llogaritë Qeveritare	TM1 2017
14.07.2017	Statistikat e Kurorëzimeve	2016
25.07.2016	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	Qershor 2017
28.07.2017	Statistikat e Shkurorëzimeve	2016
31.07.2017	Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë	TM2 2017
31.07.2017	Statistikat e Transportit	TM2 2017
31.07.2017	Buletini Tremujor	TM2 2017
10.08.2017	Indeksit Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi	TM2 2017
11.08.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Korrik 2017
14.08.2017	Indeksit Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi	TM2 2017
18.08.2017	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM2 2017
25.08.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Korrik 2017

06.09.2017	Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP)	TM2 2017
06.09.2017	Statistikat e Hotelerisë	TM2 2017
08.09.2017	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP)	TM2 2017
11.09.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Gusht 2017
11.09.2017	Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN)	TM2 2017
11.09.2017	Anketa e Ekonomive Bujqësore	2016
19.09.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Industrisë	TN2 2017
21.09.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me Pakicë	TM2 2017
25.09.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Gusht 2017
27.09.2017	Statistikat e Jurisprudencës për Persona Madhorë	2016
28.09.2017	Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit	TM2 2017
29.09.2017	Kosova në Shifra	2016
06.10.2017	Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	TM2 2017
10.10.2017	Llogaritë Qeveritare	TM2 2017
11.10.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Shtator 2017
17.10.2017	Statistikat e Kulturës	2016
25.10.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Shtator 2017
27.10.2017	Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve	2016
27.10.2017	Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve	2016
27.10.2017	Anketa e Mbeturinave të Trajtuara (AMT)	2016
31.10.2017	Buletini Tremujor	TM3 2017

31.10.2017	Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë	TM3 2017
31.10.2017	Statistikat e Transportit	TM3 2017
06.11.2017	Statistikat e Shëndetësisë	2016
06.11.2017	Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi	2016
10.11.2017	Indeksit Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi	TM3 2017
10.11.2017	Anketa e Mbeturinave Komunale (AMK)	2016
10.11.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Tetor 2017
14.11.2017	Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi	TM3 2017
17.11.2017	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM3 2017
24.11.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Tetor 2017
30.11.2017	Kalendari i Publikimeve	2018
05.12.2017	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN)	2016
07.12.2017	Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP)	TM3 2017
07.12.2017	Statistikat e Hotelerisë	TM3 2017
08.12.2017	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP)	TM3 2017
11.12.2017	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	Nëntor 2017
11.12.2017	Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN)	TM3 2017
12.12.2017	Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	TM3 2017
13.12.2017	Rezultatet e Anketës PRODCOM	2016
14.12.2017	Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë	2016
15.12.2017	Anketa e Mbeturinave Industriale (AMI)	2016
15.12.2017	Statistikat e Sportit	2016

15.12.2017	Fletëpalosja	2017
21.12.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Industrisë	TM3 2017
22.12.2017	Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me Pakicë	TM3 2017
22.12.2017	Kalendari i ASK-së	2018
26.12.2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ)	Nëntor 2017
28.12.2017	Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit	TM3 2017
29.12.2017	Llogaritë Qeveritare	TM3 2017

7. BUXHETI

Për periudhën e përmendur të Hartës Rrugore 2017, buxheti për ASK-së është si në vijim:

Buxheti për ASK 2017

Buxheti 2017	€
	MF *
Pagat & Mëditje	920,896.68
Mallrat dhe Shërbimet	307,960.02
Shpenzimet kapitale	
Shpenzimet kosto	21,875.00
TOTAL:	1,250,731.70
Numri i punëtorëve	149

*Shënim:

- Kjo është kërkesa jone e buxhetit që është dërguar në MF ende nuk kemi konfirmim për aprovim të këtij buxheti.

Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së

